

Elbasan, 28.07.2016

Komisioni për Mbrojtjen e Tokës Qarku Elbasan

Ne mbledhjen e dates 28.07.2016, te Komisionit te Mbrojtjes se Tokes na Qark moren pjese:Bukurosh Stafa Kryetar i Qarkut Elbasan, Sokol Noko Shef sektori ne Drejtorine e policise, Lutfi Gjinishi Drejtor i ARM-se, Astrit Xhelili Pergj.Sektori Bordi i Kullimit, Fadil Vrapit Shef Sektori Bashkia Elbasan, Vilson Tervoli Specialist Bashkia Gramsh, Ankleida Llapushi Specialiste e ZMMT-se B.Cerrik, Bashkim Muraci Pergj.Bujqesi-Kadaster, Ndririm Reka Inspektor i Zyres se Bujqesise B. Belsh dhe Alban Moli Dr. I DAMT-se prane Qarkut Elbasan.

Ne kete mbledhje u dha informacion mbi analizen e gjendjes se demtimeve te tokes bujqesore ne Qarkun e Elbasanit, nga faktoret njerezore e natyrore.

Ne perfundim, Komisioni i Mbrojtjes se Tokes miratoi disa detyra per muajt ne vazhdim, si me poshte vijon:

1- Ne mbeshtetje te ligjit me nr.9244, date 17.06.2004”Per Mbrojtjen e Tokes Bujqesore” neni 10, pika e duhet qe te gjitha bashkive te planifikojne ne buxhet jo me **pak se 40 % e te ardhurave** te realizuara nga tatimi per token dhe te planifikohen si fond i vecante per mbrojtjen e tokes bujqesore e cila duhet te jete e pasqyruar ne buxhetin e vitit 2016.Me kete fond duhet te fillohet urgjentisht me investimet ne zonat me te demtuara duke ndertuar mure mbajtjes, prita te ndryshme , si dhe venien ne gadishmeri te rrjetit te kanaleve vadites, kullues e antierozive.

2-Bashkive, ne zbatim te kreut IV, pika 1 e VKM-se 121 date 17.02.1011 “Per menytrat e ushtrimit te funksioneve nga drejtorite e administrimit dhe mbrojtjes se tokes ne qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes se tokes ne komuna dhe/ose bashki.”te krijojne ZMMT (Zyrat e Menaxhimit dhe Mbrojtjes se Tokes) duke caktuar specialiste me arsimin e larte ne profesion Agronom ose inxhinier gjeodet.

3-Drejtorite e sherbimit pyjor prane bashkive te percaktojne zonat me te rrezikuara nga gerryerjet me synim qe te sigurojne fonde e projekte per pyllezime te reja ne brigjet e lumenjve.

4- Nepermjet raporteve te kontrollit te Zyres se Menaxhimit dhe Mbrojtjes se Tokes (ZMMT),Keshillat e bashkive te ngrihen ne nivelin e autoritetit pergjegjes per mbrojtjen e tokes duke analizuar ne menyre sistematike gjendjen e perdorimit te tokes bujqesore per te marre vendimet perkatese ne interes te permiresimit, riaftesimit e ruajtjes se tokes bujqesore.

5- Bordi i Kullimit ne bashkepunim me strukturat e tjera te njesive te qeverisjes vendore (DAMT dhe ZMMT) te percaktoje zonat me te rrezikuara. Bordi i Kullimit ti beje te ditur bashkive projektet qe ka te perfunduara dhe atyre ne proces dhe ne varesi te demtimit te tokes bujqesore nga gerryerjet e lumenjve ne bashkepunim me bashkive perkatese te sigurojne fondet e mjaftueshme per kete qellim

6-Inspektoriati ndertimor urbanistik vendor (INUV) prane cdo bashkie ne bashkepunim me Drejtorine e Policise Elbasan te parandalojne ndertimet pa leje ne token bujqesore.

7-Agjensite e Sherbimeve Publike prane bashkive te caktojne nje person pergjegjes per hapjen dhe mbylljen e portave te veprave te marrjes se ujit vadites, pasi ne raste emergjente (renie shiu te dendur) mund te gjendemi para nje permbytje artificiale ne mase te gjere te shtepive dhe tokesbujqesore.

KOMISIONI I MBROJTJES SE TOKES

QARKU ELBASAN

Elbasan me 28.07.2016